

KONKURSI për zgjedhjen e zgjidhjeve ideale – formuese për përpunimin e prototipit të suvenireve për Çarshinë e Vjetër të Shkupit, si pjesë e iniciativës “Suvenire të reja për Çarshinë e vjetër të Shkupit”, e cila po realizohet në suaza të projektit ROCK që është pjesë e programit Horizon 2020 dhe që realizohet me përkrahje financiare

nga Bashkimi Evropian

QYTETI I SHKUPIT

shpall

KONKURS

për zgjedhjen e dhjetë zgjidhjeve ideale – formuese për përpunimin e prototipit të suvenireve për Çarshinë e Vjetër të Shkupit si pjesë e iniciativës “Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit”

Shkup, shkurt 2020

KONKURSI për zgjedhjen e zgjidhjeve ideore – formuese për përpunimin e prototipit të suvenireve për Çarshinë e Vjetër të Shkupit, si pjesë e iniciativës “Suvenire të reja për Çarshinë e vjetër të Shkupit”, e cila po realizohet në suaza të projektit ROCK që është pjesë e programit Horizon 2020 dhe që realizohet me përkrahje financiare

nga Bashkimi Evropian

QYTETI I SHKUPIT

SHPALL

KONKURS

Për zgjedhjen e dhjetë zgjidhjeve ideore – formuese për përgatitjen e prototipit të suvenireve si pjesë e iniciativës “Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit”

ORGANI KONTRAKTUES

Organi kontraktues është Qyteti i Shkupit, me seli në Bulevardin “Ilinden” nr.82, 1000 Shkup, numri i telefonit për kontakt (02) 3297 524, posta elektronike e-mail:elizabetha.stefkovska@skopje.gov.mk, personi për kontakt: Elizabeta Stefkovska.

KUSHTET E KONKURSIT

- Konkursi është publik dhe anonim. Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë personat fizik ose juridik të cilët janë të interesuar dhe konsiderojnë se mund t'i plotësojnë kushtet e konkursit.
- Çdo pjesëmarrës i konkursit është i detyruar ta paraqesë punimin konkurrues në pajtim me kërkesat e konkursit. Punimet që nuk do ta plotësojnë këtë kusht, nuk do të shqyrtohen nga Komisioni përzgjedhës.
- Materialet e konkursit dhe e gjithë korrespondenca lidhur me konkursin duhet të jetë në gjuhën maqedonase.

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E KONKURSIT

Përbërja e Komisionit për përzgjedhje

Vlerësimin e punimeve do ta bëjë Komisioni përzgjedhës në përbërjen e të cilit do të marrin pjesë përfaqësues të shpallësit të konkursit, përkatësisht Qytetit të Shkupit, nga Fakulteti arkitektonik dhe nga Fakulteti i arteve të bukura pranë Universitetit “ Shën Qirili dhe Metodi”, nga SHTAM - Shoqata e tregtisë së artizanëve të Maqedonisë si dhe anëtarë të spikatur në Komunitetin e industrive kreative.

Puna e Komisionit përzgjedhës

- Komisioni përzgjedhës do ta realizojë vlerësimin e punimeve konkurruese.
- Komisioni përzgjedhës do të parashtroj raport për punën e tij deri te organi Kontraktues dhe pjesëmarrësit e konkursit, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e tij, në të cilin është i paraqitur vlerësimi i punimeve.
- Rezultatet nga vlerësimi do të publikohen në ueb faqen zyrtare të internetit dhe në profilet e rrjeteve sociale të Qytetit të Shkupit.
- Autorët e punimeve të shpërblyera, si dhe pjesëmarrësit tjerë do të jenë të informuar me shkrim për rezultatet e punës të Komisionit përzgjedhës.
- Në qoftë se cilësia e veprave të dorëzuara është e kënaqshme, komisioni do të sjellë vendim për përcaktimin e 10 punimeve të shpërblyera dhe me autorët e tyre do të nënshkruaj kontratë për vepër, për bartjen e të drejtave autoriale.
- Në qoftë se Komisioni vendos që propozimet e dorëzuara nuk i plotësojnë kriteret e këtij Konkursi, atëherë mban të drejtën që të përzgjedh më pak se 10 punime ose të mos përzgjedh asnjë prej zgjidhjeve të ofruara dhe ta përsëris Konkursin.
- Anëtarët e Komisionit përzgjedhës nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje në këtë konkurs.
- Propozimet për suveniret të cilat nuk do të përzgjidhen mund të tërhiqen në afatin prej 30 ditëve nga dita e realizimit të ekspozitës, personalisht nga hapësirat e Qytetit të Shkupit.

Kriteret e vendosjes

- Respektimi i parimeve themelore të iniciativës „ Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit “;
- Cilësi të dizajnit të propozuar dhe qëndrueshmëri të materialeve të propozuara për përpunim;
- Inovacioni, kreativiteti dhe niveli i lartë i përshtypjeve të shprehjes së formësuar;
- Vlera kulturore e dizajnit;
- Realizimi dhe shumimi i thjeshtë;
- Qëndrueshmëria, mbështetja ekonomike dhe prodhuese e zgjidhjes;
- Potenciali shitës i produktit që pason nga zgjidhja;
- Qëndrueshmëria ekologjike e zgjidhjes.

LËNDA E KONKURSI

Përgatitja e zgjidhjeve ideore-formuese të suvenireve për Çarshinë e Vjetër të Shkupit si pjesë e iniciativës „Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit“

QËLLIMI DHE DETYRAT E KONKURSI

Konkursi shpallet si pjesë e iniciativës „Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit“ dhe ka për qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e kësaj tërësie kulturore-historike në qytetin e Shkupit dhe promovimin e vlerave të saja. Në këtë kontekst, zgjidhjet e ofruara duhet të theksojnë vlerat e trashëgimisë kulturore, zanatet e vjetra dhe të jenë pasqyrim i traditës dhe vlerave kulturore, historike, materiale dhe shpirtërore të Çarshisë së Vjetër të Shkupit si tërësi e mbrojtur kulturore, me rëndësi të veçantë dhe me trashëgimi të pasur kulturore-historike.

Në të njëjtën kohë, qëllimi është që nëpërmjet këtij konkursi të mundësohet identifikimi, promovimi dhe përfshirja e potencialit kreativ dizajnues me qëllim i njëjti të japë kontributin e drejtpërdrejtë në krijimin e suvenireve moderne dhe në frymën e kohës;

Qëllimi është përmirësimi i ofertës së suvenireve për Qytetin e Shkupit me qasje inovative të industrive kreative, përkatësisht pasurimi i ofertës turistike – komerciale të Çarshisë si një nga ambientet më atraktive të qytetit.

KËRKESAT QË KANË TË BËJNË ME DIZAJNIN

Zgjidhjet e propozuara duhet të synojnë drejt zgjidhjeve të thjeshta dhe ekonomike, riprodhimi i të cilave do të ishte i thjeshtë, kurse manipulimi dhe transporti i lehtë në të gjitha mjetet e transportit që do të përdoren nga blerësi.

Do të përkrahen zgjidhje të cilat përdorin materiale të qëndrueshme dhe të pranueshme ekologjike (p.sh.: qeramikë, gur, terakotë, dru, tekstil, qelq, metal, lesh, etj).

Zgjidhja e konkursit duhet të përmbajë përshkrim të shkurtër të punëve të parashikuara dhe llogaritje të përafërt të kostos së realizimit të zgjidhjes ideore të propozuar.

PËRMBAJTJA E PUNIMEVE TË KONKURSIT

Punimi i konkursit duhet të përmbajë:

- Përshkrimi tekstual duhet të përmbajë më së shumti 1500 fjalë, në të cilin përfshihen përshkrimi për konceptin e zgjidhjes së propozuar, përshkrimi i idesë dhe frymëzimit, përshkrimi i hollësishëm i elementeve kryesore të zgjidhjes, si dhe madhësia, ngjyrën e materialeve nga të cila do të prodhohet prodhimi i dizajnuar, arsyeshmëria dhe mundësia e realizimit, teknikat dhe teknologjitë e prodhimtarisë dhe shumimit, çmimi i supozuar i prodhimit, si dhe propozimi për prodhuesin e mundshëm.
- Skica teknike e dizajnit (e punuar në mënyrë kompjuterike ose në mënyrë manuale).
- Skica për vizualizim më të mirë të dizajnit të propozuar (e punuar në mënyrë kompjuterike ose në mënyrë manuale, e dorëzuar si shtojcë).
- Sipas nevojës për prezantim më të detajuar të idesë, mund të shfrytëzohet edhe në proporcione të ndryshme të cilat do të duhet të shënohen në mënyrë të qartë.
- Të gjitha shtojcat duhet të posedojnë përshkrime / legjendën përkatëse.
- Një ekzemplarë nga suveniri, në madhësi dhe në materialin origjinal, përkatësisht prototipin – mostrën e punuar.

KUSHTET E KONKURSIT

Pajisjet e punimeve të konkursit

Shtojcat grafike dhe tekstuale, duhet të jenë të integruara në një tërësi të vetme të shtojcave me dimensione 50/70 cm.

Punimi i konkursit nuk duhet të shënohet me shifër.

Gjatë vlerësimit të punimeve, të gjitha punimet do të përcaktohen me shifrën e punës.

Si shtojcë e punimit, dorëzohet edhe regjistrimi digjital i të gjitha shtojcave në formatin PDF në CD ose në USB.

Të gjitha shtojcat e punimit konkurrues (prototipi / mostra, shtojcat grafike dhe tekstuale) duhet të paketohen në një mbështjellës të përbashkët të pa tejdukshëm ku do të shënohet:

KONKURS për zgjedhjen e zgjidhjeve ideale – formuese për përpunimin e prototipit të suvenireve për Çarshinë e Vjetër të Shkupit – “Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit”.

Mbështjellësi i punimit nuk guxon që të përmbaj shënime të tjera të cilat do të mund ta komprometonin anonimitetin e punimit.

Në mbështjellësin e përbashkët të punimit konkurrues duhet të dorëzohen edhe:

Lista e përmbajtjes së punimit (ku do të theksohen me numër rendor shtojcat të cilat janë të përfshira në punimin) dhe dy zarfe të vulosura, nga të cilat njëri me shenjën “**autori**”, kurse tjetri me shenjën “**adresa për kthimin e punimit**”.

Në zarfin me shenjën „**autori**“ qëndron emri dhe adresa e autorit / autorëve, si dhe raporti i përqindjes së ndarjes së çmimit eventual në mes autorëve për punimin e realizuar.

Në zarfin me shenjën „ **adresa për kthimin e punimit**“ theksohet adresa për kthimin e punimit i cili nuk do të shpërblehet dhe pëlqimi për shpalljen publike të emrit të autorit / autorëve të punimit në suaza të ekspozitës që do të organizohet.

Afati i dorëzimit të punimeve konkurruese

Afati përfundimtarë për dorëzimin e punimeve është 10.04.2020 deri në ora 12.

Punimet konkurruese mund të dorëzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të dorëzohen përmes postës së shpejtë.

Punimet konkurruese dorëzohen drejtpërdrejtë në Arkivin e Qytetit të Shkupit ose përmes postës së shpejtë në adresën: Qyteti i Shkupit, bul. “Ilinden” nr. 82, Shkup.

Punimet të cilat do të dorëzohen pas skadimit të këtij afati, ose punimet të cilat do të bartin me vete vulën postare pas terminit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit të përzgjedhjes.

Pjesëmarrësit në konkursin, gëzojnë të drejtën që të parashetrojnë pyetje të drejtpërdrejta që kanë të bëjnë me konkursin më vonë deri më datën 16.03.2020.

Të gjitha pyetjet dorëzohen në trajtë të shkruar përmes rrugës elektronike në e – mail adresë: elizabetha.stefkovska@skopje.gov.mk

Komisioni i konkursit do ta përfundojë punën dhe do ti shpall rezultatet e konkursit më vonë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të punimeve.

Rezultatet do të shpallen në ueb faqen zyrtare si dhe në profilet e Qytetit të Shkupit në suaza të rrjeteve sociale.

Nga punimet e dorëzuara dhe të shpërblyera, do të organizohet ekspozita e përbashkët për prezantim para opinionit më të gjerë. Ekspozita e punimeve të shpërblyera dhe të punimeve të tjera do të realizohet në hapësirat e SkULL – Labororit të gjallë të qytetit në suaza të Çarshisë së Vjetër të Shkupit. Termi i mbajtjes së ekspozitës do të shpallet në ueb faqen, në rrjetet sociale dhe në mediat.

Dispozitat përfundimtare

- Me dorëzimin e punimit konkurrues (zgjidhjeve ideore) çdo pjesëmarrës i pranon rregullat e konkursit;
- Çdo pjesëmarrës - individ ose grup, mund të marrë pjesë me më shumë zgjidhje ideore;
- Komisioni vlerësues, nuk do të sh urtojë ato punime konkurruese të cilët do të arrijnë pas afatit të përcaktuar, ose punimet që nuk janë të punuara sipas programit dhe konkursit të shpallur;
- Anëtarët e Komisionit të përzgjedhjes, nuk kanë të drejtën e pjesëmarrjes në këtë konkurs.
- Autorët e dhjetë punimeve të përzgjedhura do të lidhin kontratë për vepër me Qytetin e Shkupit, për bartjen e të drejtave autoriale, në bruto shumën prej **90.000 denarë**.
 - Me nënshkrimin e kontratës për veprat autoriale, pjesëmarrësi në këtë konkurs është i pajtimit që projekti dhe të gjitha shtojcat që janë pjesë përbërëse e punimit konkurrues, shpallësi i konkursit të mund të shfrytëzojë për prezantime dhe promovime të iniciativës: “Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit” dhe për aktivitete të tjera të Laboratorit të gjallë të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.
 - Pjesëmarrësi në këtë konkurs është i pajtimit që Qyteti i Shkupit të shfrytëzojë zgjidhjet e blera “Suvenire të reja për Çarshinë e Vjetër të Shkupit” për realizimin e furnizimit publik për prodhuesit dhe shumëzuesit e zgjidhjeve për suveniret, Qyteti i Shkupit me këtë përfiton të drejtën e disponimit me të drejtat autoriale.
 - Qyteti i Shkupit, disponon me mundësinë që në konsultim me autorin e zgjidhjes së shpërblyer, të realizojë ndryshime të caktuara të cilat do ta lehtësojnë prodhimtarinë shumë.
 - Qyteti i Shkupit, disponon edhe me mundësinë, nëse autori do të jetë në gjendje që ta prodhojë suvenirin, dizajni i të cilit është blerë, të lidh kontratën për prodhimin të suvenirit.

QYTETI I SHKUPIT
Kryetari i Qytetit të Shkupit

Petre Shilegov